

VENDIM
Nr.1519, datë 21.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1415, DATË 22.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË
FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E
PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE QENDRA
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, SI AUTORITETE
KONTRAKTORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.1415, datë 22.10.2008 të Këshillit të Ministrave, pas shprehjes “... 8 dhjetor 2008.” shtohet shprehja, “... , ndërsa për pikën 3, të këtij aneksi, si afat të jetë data 29 dhjetor 2008.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha